

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS– Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi dhe Afrim Shala, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Leonita Lajçi, si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.U. nga fsh. Gelancë Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose të autorizimit, parashikuar me nenin 339 par.2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose të autorizimit, parashikuar me nenin 339 par.3 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), dhe veprës penale Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.1 nënpar.3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK), duke vendosur përkritazi me ankesën e mbrojtësve të akuzuarit H.U. , të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, PKR.nr.24/2015 datë 24.03.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18.06.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Me aprovimin e ankesës së mbrojtësve të akuzuarit H.U. ,e sipas detyrës zyrtare, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, PKR.nr.24/2015 datë 24.03.2017 përkritazi me cilësimin juridik të veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose të autorizimit, parashikuar me nenin 339 par.3 lidhur me par.1 të KPK, ashtu që kjo gjykatë këtë vepër penale e cilëson si vepër penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, kështu që për këtë vepër penale dhe veprën penale Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.1 nënpar.3 të KPK, kundër të akuzuarit H.U. , refuzohet akuza konform dispozitës së nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), lidhur me nenin 91 par.6 te Kodit Penal të Kosovës (KPK), për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

II. Aktgjykimi i shkallës së parë përkritazi me pjesën refuzuese ngel i pa prekur.

III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, PKR.nr.24/2015 datë 24.03.2017, i akuzuari H.U. , është refuzuar akuza për shkak të veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose të autorizimit, parashikuar me nenin 339 par.2 të KPK , ndërsa është shpallur fajtor për shkak të veprës penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose të autorizimit, parashikuar me nenin 339 par.3 lidhur me par.1 të KPK, dhe veprës penale Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.1 nënpar.3 të KPK, ashtu që për veprën penale nën pikën I të dispozitivit të aktakuzës i ka shqiptuar dënimin me burg në kohëzgjatje prej 8 muajve ndërsa për veprën penale nën pikën III dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muajve ashtu që konform nenit 71 të KPP i ka shqiptuar dënimin unik në kohëzgjatje prej 12 muaj në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 09.07.2008 deri me datën 15.07.2008. E dëmtuara ... dhe Administrata Tatimore e Kosovës për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest juridiko-civil. Është obliguar që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 400 euro.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin PAKR.294/17 të dt. 18.08.2017 ka pranuar pjesëshëm ankesën e mbrojtësit të akuzuarit H.U. por edhe sipas detyrës zyrtare, duke

ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë vetëm përkitazi me cilësimin juridik të veprës penale Shpërdorim i detyrës zyrtare ose i autorizimit nga neni 339 par.3 e lidhur me par.1 të KPK duke e cilësuar të njëjtën në vepër penale Keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. E.R. me datë 28.09.2017 ka ushtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të shkeljeve të Ligjit Penal dhe shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Gjykata Supreme me aktgjykimin PML.nr.281/17 të dt. 16.04.2018 ka aprovuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit H.U. , ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit PAKR.294/17 të dt. 18.08.2017 dhe çështja i është kthyer kësaj gjykate në rivendosje.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë kanë paraqitur:

- mbrojtësi i të akuzuarit H.U. , av. E.R., për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale, vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënim, me propozim qe aktgjykimi te ndryshohet dhe i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza ose ti shqiptoj dënim më të butë apo aktgjykimi të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

- mbrojtësi i të akuzuarit H.U. , av. H.V., për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale, vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, me propozim qe aktgjykimi te ndryshohet dhe i mbrojturi i tij të lirohet nga akuza ose ti shqiptoj dënim më të butë apo aktgjykimi të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit e Kosovës mbajti seancën e kolegjit në të cilën nuk prezantoi Prokurori i Apelit, mbrojtësi i të akuzuarit av. H.V. dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av. Sh.B. ndërsa prezent ishin i akuzuari H.U. dhe mbrojtësi i tij av. E.R.. Mbrojtësi mbeti pranë pretendimeve ankimore duke shtuar se ka arritur parashkrimi absolut i veprave penale dhe propozon që të refuzohet akuza. I akuzuari mbështeti mbrojtësin e tij.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.285/2017 datë 13.06.2017, ka propozuar që ankesa e mbrojtësve të akuzuarit të refuzohen si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtojë të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studiojë aktgjykimin e kundërshtuar në kuptim të dispozitës së nenit 394 të KPP gjeti se:

- aktgjykimi i shkallës së parë detyrimisht duhet të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke e shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë në pjesën për të cilën është ushtruar ankesë, dhe sipas detyrës zyrtare konform dispozitës së nenit 394 të KPP, përkitazi me shkeljen e ligjit penal Gjykata e apelit vlerëson se me aktgjykimin e kundërshtuar është shkelur e ligji penal në anën e të akuzuarit ngase në rastin ndjekja penale është parashkruar respektivisht ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Kështu, nga aktgjykimi i kundërshtuar del se i akuzuari H.U. është shpallë fajtor për veprën penale Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit, parashikuar me nenin 339 par.3 lidhur me par.1 të KPK, për të cilën vepër penale kjo gjykatë e ka ri cilësuar si

keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK, si Ligj më i favorshëm për të akuzuarin, ku dënimi me burgim është prej 6 muaj deri në 1 vit, kurse vepra penale rezulton të jenë kryer me datë 13.11.2007, ndërsa për veprën penale Keqpërdorimi i autorizimeve në ekonomi nga neni 236 par.1 nën.par 3 të KPK, dënimi i paraparë me ligj është prej 6 muaj deri në 5 vjet, ndërsa vepra rezulton të jetë kryer në fund të vitit 2007 e gjer në muajin prill 2008. Sipas dispozitës së nenit 90 par. 1 pika 4 të KPK i cili ishte i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale dhe gjatë zbatimit të procedurës penale në shkallë të parë, për veprat penale të dënueshme mbi 3 vite burgim ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 5 vite nga kryerja e veprës penale, ndërsa sipas dispozitës së nenit 91 par. 6 të KPK, ndjekja penale ndalohet me çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Duke pas parasysh se afati i parashkrimit fillon nga dita kur është kryer vepra penale, rezulton se që nga koha kur pretendohet se janë kryer vepra penale (13.11.2007 dhe prill 2008) e deri në mbajtjen e seancës së kolegjit të kësaj Gjykate gjegjësisht edhe gjatë kohës së shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë, kanë kaluar mbi 10 vite, çka do të thotë se në rastin konkret ndaj të akuzuarit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor ka arritur parashkrimi absolut i ndjekës penale.

Meqë, në rastin konkret ka kaluar dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrim, aktgjykimi i kundërshtuar u dashtë të ndryshohet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për ç ‘arsye ankesa e mbrojtësve të akuzuarit H.U. është jo lëndore, kurse shpenzimet e procedurës penale konform dispozitës së 454 par.1 të Kodit të Procedurës Penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitës së nenit 403 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.234/2018, me 18.06.2018

Procesmbajtësja,
Leonita Lajçi

Kryetarja e kolegjit,
1. Mejreme Memaj

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc..Driton Muharremi

3. Afrim Shala